



A.nr.566/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.566/2026, të datës 22.05.2026, të parashtruar nga ankuesja D.GJ, nga Prishtina kundër organit të punësimit/Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më objekt kontesti “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.566/2026, e datës 22.05.2026, e parashtruar nga ankuesja D.GJ, ashtu që *aprovohet* pretendimi i ankueses lidhur me mos evidentimin e dosjes personale në SIMBNJ, ndërsa *refuzohet* pretendimi ankimor i ankueses për mos finalizimin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024.

II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke ndërmarr të gjitha veprimet që dosja personale e ankueses në SIMBNJ të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, D.GJ (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 22.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos veprimit administrativ lidhur me procedurën e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 28.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 03.06.2026, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2446/2026 të datës 22.05.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin e datës 06.05.2026 të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Diplomën e ankueses; Certifikatat e trajnimeve dhe të ndryshme të ankueses; Pasqyrën e sistemit nga SIMNJ të dërguar nga ankuesja me ankesë; Emailin e datës 30.04.2026 nga F.M për ankuesen; Emailin e datës 27.04.2026 nga ankuesja për F.M; Emailin e datës 20.01.2026, 19.01.2026, 31.12.2025, 26.12.2025 nga F.M për ankuesen; Emailin e datës 20.01.2026, 19.01.2026, 12.01.2026, 31.12.2025, 24.12.2025 nga ankuesja për F.M; Emailin e datës 24.12.2025 nga B.L për ankuesen; Emailin e datës 18.12.2025 nga ankuesja për T.M; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 03.06.2026; Akt Emërimit të ankueses; Emailin e datës 27.01.2025 nga F.M për HR; Njoftimin e datës 27.01.2025 nga DMZP; Plani Vjetor i punës janar-dhjetor 2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen nga SIMBNJ i datës 27.03.2025 dhe konfirmimin nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i datës 27.03.2025; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin Fizik i datës 27.05.2025; Emailin e datës 22.07.2025 nga ankuesja për M.P, F.M dhe T.M; Kërkesën për inicim të rastit e datës 15.01.2026; Emailin e datës 29.12.2025 nga F.M për B.L; Emailin e datës 29.12.2025 nga F.M për M.P; Emailin e datës 30.12.2025 nga M.P për F.M; Emailin e datës 29.05.2025 nga M.P për ankuesen; Emailin e datës 13.03.2026 nga J.A për B.L; Emailin e datës 16.03.2025 nga B.L për J.A; Emailin e datës 03.03.2026 nga F.G për ankuesen; Emailin e datës 20.02.2026 nga ankuesja për F.G; Kërkesën për informata zyrtare për F.M nga A.B; Vendimin e datës 02.07.2026 për zgjatjen e afatit për vendosje të ankesës.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa është e pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Nga provat e administruara rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 04.10.2023, mban pozitën Zyrtare e Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Tutje sipas provave të lëndës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses më datës 27.03.2025, përmes sistemit, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen dhe vlerësimi i përgjithshëm sipas këtij vlerësimi është **Arrin pritshmërinë**, pra ky vlerësim është i konfirmuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), mirëpo sipas emailit të datës 29.05.2025, rezulton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka bashkangjitur formularin për vlerësimin e rezultateve në punë në email i cili është nënshkruar më datë 27.05.2025, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses dhe vetë ankuesja, dhe sipas këtij formulari rezulton se vlerësimi i përgjithshëm është Arrin Pritshmërinë.

Ankuesja përmes emailave të datës 17.12.2025, datës 18.12.2025, datës 24.12.2025 datës 30.12.2025, datës 31.12.2025, datës 19.01.2026, ka kërkuar që meqë ka vlerësimin e vitit 2024 tejkalon pritshmërinë të bëhet finalizimi i vlerësimit, ndërsa është njoftuar përmes emailave se janë duke i shqyrtuar të gjitha çështjet sepse ka mospërputhje mes vlerësimit në sistem dhe atij fizikisht.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është përfunduar procesi i vlerësimit dhe kam kërkuar qasje në dokumente publike dhe më është dorëzuar vetëm një vlerësim. Kërkon që të aprovohet ankesa të obligohet institucioni për finalizimin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024. Po ashtu ankuesja pretendon se nuk janë reflektuar në SIMBNJ, dosja personale e saj.

Ndërsa, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me vlerësimin e vitit 2024, respektivisht finalizimit të këtij vlerësimi, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 52 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *“1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësitqë ka në vartësi. 9. Përrjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrës/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1.*

arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme. 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 16. Periudha e vlerësimit të veçantë sipas paragrafit 15. të këtij neni, është sa një e katërta (1/4) e periudhës së vlerësimit vjetor të përcaktuar sipas paragrafit 2. të këtij neni. 17. Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative... ”.

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, në fuqi nga data 15.10.2024, me theks të veçantë: Nenin 4 [Përcaktimi i objektivave] 1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NjMBNj siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij. 2. Plani individual i punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësin civil. 3. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë. 4. Përcaktimi i objektivave dhe plani individual për arritjen e objektivave bëhen në muajin Janar të çdo viti, përmes SIMBNj-së. 5. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit, të njësisë ku është i punësuar nëpunësi dhe në përshkrimin përkatës të punës. 6. Formulari i gjeneruar nga SIMBNj, ruhet edhe në dosjen individuale, Nenin 5 [Vlerësimi i rezultateve të punës] 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 2.1. realizimin e detyrave të punës që përfshin; 2.1.1. objektivat e përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit; dhe 2.1.2. kryerjen e detyrave të tjera që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen. 2.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesi civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 2.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesi civil gjatë ushtrimit të detyrës. 3. Përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, konfirmon objektivat dhe vlerësimin e rezultateve në punë, për nëpunësin civil në SIMBNj, Nenin 9 [Nivelet e vlerësimit] 1. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 1.1. arritje e jashtëzakonshme; 1.2. tejkalon pritshmërinë; 6 / 8 1.3. arrin pritshmërinë; 1.4. ka nevojë për përmirësim; 1.5. e papranueshme... 3.4. “Ka nevojë për përmirësim” është vlerësim që tregon se nëpunësi civil nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij. Ekzistojnë fusha ku kërkohet përmirësim i dukshëm për të arritur nivelin e pritshëm të performancës; ...4. Në rastin e vlerësimit në nivelet “e papranueshme” dhe “ka nevojë për përmirësim”, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në, e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësi duhet t'i ndjekë vitin që vjen në tre mujorin

e parë pas vlerësimit. NjMBNJ, sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 6. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i NjMBNJ-së, e zhvillojnë takim me nëpunësin për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët.

Kolegji i Këshillit, sipas provave të lëndës konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses më datë 27.03.2025, përmes sistemit, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen dhe vlerësimi i përgjithshëm sipas këtij vlerësimi është Arrin pritshmërinë, pra ky vlerësim është i konfirmuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), pra ky vlerësim është bërë në kuptim dhe sipas kërkesave të Rregullores (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë. Edhe pse ka përfunduar vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen në SIMBNJ, më datë 27.03.2025, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas provave të lëndës, respektivisht përmes emailit të datës 29.05.2025, rezulton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka bashkangjitur formularin për vlerësimin e rezultateve në punë në email i cili është nënshkruar më datë 27.05.2025, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses dhe vetë ankuesja, dhe sipas këtij formulari rezulton se vlerësimi i përgjithshëm është Arrin Pritshmërinë, ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses më datë 30.12.2025, ka njoftuar Menaxherin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, se ka dërguar formularin e datës 29.05.2025 për ankuesen duke e njoftuar *se vlerësimi i bërë nga ana ime dërguar D.Gj më datë 29.05.2025 është vlerësimi i bërë nga ana ime dhe se formulari i dërguar nga D.Gj më datë 22.07.2025 përveç faqes së fundit ku është nënshkruar nga të dy palët si vlerësim Arrin Vlefshmërinë faqet e vlerësimit janë korrigjuar nga vetë D.GJ në vlerësimin e bërë më datë 29.05.2025 (Formulari 2). I njëjti vlerësim është vendosur nga ana ime edhe në sistemin HRMIS/SIMBNJ më datë 27.03.2025.*

Pra, Kolegji i Këshillit, nga provat e lëndës, konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen sipas SIMBNJ i datës 27.03.2025, është vlerësim i përgjithshëm-Arrin Pritshmërinë, dhe sipas Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, po ashtu edhe vlerësimi i rezultateve në punë i nënshkruar më datë 27.05.2025 rezulton se vlerësimi i përgjithshëm është Arrin Pritshmërinë, pra bazuar në këto rrethana duke qenë se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është sipas vlerësimit të përgjithshëm Arrin pritshmërinë, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastet kur vlerësimi i përgjithshëm është Arrin Pritshmërinë nuk kërkohet konfirmi nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për shkak që sipas shkresave të lëndës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka konfirmuar se vlerësimi për ankuesen është Arrin Pritshmërinë, kështu që pretendimi i ankueses se duhet finalizuar vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2024 është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin për përditësimin e dosjes personale e cila në SIMBNJ, nuk është në pajtim me Rregulloren (MPB) 05/2024 për Dosjen Individuale dhe Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit, përmes përgjigjes në ankesë të datës 03.06.2026, nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankueses sa i përket përditësimit të dosjes personale në SIMBNJ, dhe po ashtu më datë 19.07.2026, kemi kërkuar informata nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, nëse në

SIMBNJ janë të përfshira te gjitha të dhënat për ankuesen, duke përfshirë dokumentacionin e dosjes personale, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje.

Në shqyrtim të provave të lëndës, gjegjësisht dokumenteve të bashkëngjitura nga ankuesja përmes ankesës, evidentohet se në SIMBNJ, është përshkruar arsimi, përvoja e punës si dhe trajnimet, mirëpo sipas këtyre provave përveç përshkrimit nuk janë të ngarkuara dokumentet përkatëse, andaj në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 4, dhe 6 Rregullores (MPB) Nr.05/2024 për Dosjen Individuale dhe Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkak që dosja individuale ruhet në formën fizike dhe elektronike në SIMBNJ dhe përditësohet nga secili institucion, sa herë që ka ndryshim, kështu që pretendimi i ankueses është i bazuar, e për rrjedhojë duke u bazuar në dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është e obliguar që të ndërmerr të gjitha veprimet që dosja personale e ankueses në SIMBNJ të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kështu që, bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.566/2026, më datë 23/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses D.GJ;
- Organit të punësimit: Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.